



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 47

Prishtinë, më 7 maj 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Behar Selimi - nënkryetar, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Haki Demolli, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Halit Krasniqi, Amir Ahmeti dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Arben Gashi dhe Mufera Shinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Drita Rexhepi, Anita Alaj- Kalanderi dhe Daut Morina – Agjencia për ndihmë juridike falas, Saranda Pajaziti – NDI, Arben Shanolli – ISKP, Lejla Selimi – OSBE, Petrit Hysaj – OSBE, Liridon Doberdolani NDI – praktikant, Isuf Zejna – KDI dhe Artan Canhasi – EULEX.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Behar Selmi, nënkryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.04.2012;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Komisionit për ndihmë juridike, për vitin 2011;
4. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës,

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.04.2012

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 5.04.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Komisionit për ndihmë juridike, për vitin 2011

Drita Rexhepi, përfaqësuese e Komisionit të Ndhmës Juridike - E njoftoi Komisionin se tani jemi në fazën e transformimit nga Komisioni për Ndhmë Juridike në Agjencinë për Ndhmë Juridike, pasi tashmë është miratuar Ligji për Ndhmën Juridike falas. Ajo përmendi se sfidë kryesore e Komisionit për Ndhmë Juridike konsiderohet mangësia e buxhetit, pasi çdo herë numri i personave që janë të interesuar për këtë ndihmë është në rritje. Bashkëpunimi më i rëndësishëm për Komisionin për Ndhmë Juridike u përmend ai me Odën e Avokatëve, Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Ministrinë e Drejtësisë, konkretisht me Divizionin për mbrojtjen e viktimave.

Në Komisionin për Ndhmë Juridike praktikën e kanë mbajtur 17 praktikantë, si rezultat i marrëveshjes me Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Juridik.

Buxheti është menaxhuar në bazë të ligjit, dhe vitin e kaluar janë angazhuar 444 avokatë, ndërsa në këtë vit 219, ngase nga Ministria e Financave është kërkuar të mos angazhohet numër të madh të avokatëve, si rezultat i mjeteve të limituara buxhetore. Fushatë në të cilën Komisioni për ndihmë juridike u ka ofruar mbështetje qytetarëve që janë në lëmin civil, penal dhe administrativ.

Albulena Haxhiu- Ajo shprehu shqetësimin që këtij institucioni nuk i kushtohet vëmendje sa duhet duke e pasur parasysh që mungesa e buxhetit e bën të vështirë punën e Komisionit. Ju theksuat se janë 3858 raste të cilat janë zgjidhur edhe sa prej këtyre lëndëve kanë pasur efekt që kanë qenë në anën e mbrojtur?

Arsim Bajrami- E vlerësoi se raportimi nga ana e përfaqësueses ishte korrekt. Ai pyeti se a keni ndonjë studim, sa është kualiteti i kësaj ndihme juridike? Sa raste keni fituar ju, si Ndhmë Juridike, në rastet kur keni përfaqësuar palët dhe nëse ekziston mundësia të paraqitet në formë tabelore? Nëse jo këtë vit, të paktën vitin e ardhshëm, jemi të interesuar që kjo ndihmë juridike të jetë kualitative.

Haki Demolli- Përgëzoi Komisionin për punën e përgjithshme. Dua të ndalem te sfidat dhe rekomandimet, konkretisht te rekomandimi për rritjen e buxhetit, gjatë vitit 2011, ju keni theksuar se keni pasur 4742 lëndë, dua të di, sa i ka kushtuar komisionit një lëndë, dhe sa kanë qenë kërkesat për ndihmë juridike në tërësi? Po ashtu është përmendur në raport edhe organizmi i një konference rajonale për ndihmë Juridike, thjesht më intereson të di deri ku kanë arritur përgatitet?

Armend Zemaj- E përkrahi raportin në parim, por do të jap disa vërejte te rekomandimet. Fillimisht nëse do të pyetsha unë nuk do të ekzistonte fare ky komision. Sepse po të funksiononte sistemi nuk do të kishim nevojë për këtë komision. Problematika e buxhetit, sipas këtij raporti, me sa kam kuptuar nuk qëndroni edhe aq keq duke analizuar shifrat e pagave, ndoshta e keni një sqarim shtesë që t'i kemi gjërat më të qarta. Ai vlerësoi se rekomandimet nuk do të duhej të ishin pjesë e raportit, pasi rekomandimet i paraqesim në Kuvend, si Komision. Po ashtu jam i interesuar të di angazhimi i avokatëve, a po flitet për raste, apo për individë nëse ka mundësi të sqarohet?

Ardian Gjini- Tha se është me rëndësi të dihet në mënyrë precize për ato që theksuan parafolësit, besoi se Kuvendi ka nevojë që të jetë i informuar me shifra konkrete, që të ketë një analizë më të qartë. E përkrahi në mënyrë parimore raportin.

Pyetjeve të anëtarëve ju përgjigje Drita Rexhepi, koordinatorë Komisionit të ndihmës juridike falas.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet Raporti i punës i Komisionit të Ndhmës Juridike për vitin 2011.

4. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Kryesuesi, kërkoi vëmendjen e anëtarëve të Komisionit se propozimi nga Bordi i Shoqatës së Gjyqtarëve është bërë me logo dhe vulë të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje. Ndoshta do të duhej që shkresa të jetë me logo dhe vulë të Shoqatës së Gjyqtarëve.

Komisioni vlerësoi se kjo nuk përbën ndonjë pengës dhe propozimet mund të procedohen për mbledhje plenare.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës këta kandidatë:

1. Fejzullah Hasani dhe Nebojsa Boriq – Gjykata Supreme e Kosovës,
2. Laura Pula – Prokuroria Publike e Kosovës,
3. Osman Ismaili – Fakulteti Juridik,
4. Rexhep Murati – Shoqata e Juristëve të Kosovës,
5. Idain Smaili – Shoqata e Prokurorëve të Kosovës,
6. Ramë Gashi – Oda e Avokatëve të Kosovës,
7. Ymer Hoxha – Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës.

5. Të ndryshme

Kryesuesi kërkoi të lirohet nga kryesimi i grupit punues për hartimin e Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit dhe propozoi që kryesues të jetë Armend Zemaj.

Komisioni vendosi që kryesues i GP për Projektligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit të jetë Armend Zemaj.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetari i Komisionit

Behar Selimi